REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 11/17
Datë/Datum. 02.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

PSH. nr. 11/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje Tefik Sylejmani –Kryetar, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 476/16, të parashtruar nga operatori ekonomik NTP"SNR" me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me Kushineta dhe hilnze" me nr. të prokurimit KEKO 16/356/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Korporata Energjetike e Kosovës , në seancën e dt. 27.02.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik NTP"SNR" me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me Kushineta dhe hilnze" me nr. të prokurimit KEKO 16/356/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Korporata Energjetike e Kosovës.

II. **Anulohet**, vendimi i autoritetit kontraktues Korporatës Energjetike të Kosovës lidhur me njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizimi me Kushineta dhe hilnze" me nr. të prokurimit KEKO 16/356/121 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues "SNR"me seli në Prishtinë konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

VI. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues– Korporata Energjetike e Kosovës, ka bërë njoftimin për kontratë me dt.26.09.2016, procedurë e hapur , kontratë për furnizim me vlerë të mesme.

Afati i fundit për ofertim ka qenë data 24.10.2016.

OE të interesuar për këtë aktivitet kanë qenë gjithsej 2 OE.

AK ka formuar komisionin vlerësues prej tre anëtarëve me qëllim të vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave dhe I njejti komision rekomandon anulimin e aktivitetit të prokurimit me datë 23.12.2016 me arsyetim se asnjë ofertë nuk ka qenë e përgjegjshme.

Me datë 13.01.2017 OE:"SNR" në shqnjë mos pajtimi me anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit parashtron ankesë në OSHP me dt.13.01.2017 me nr.të prot.11/17, me pretendime ankimore se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 7 par.1, 2 dhe 4, nenit 4 dhe nenit 59 të LPP-së, dhe kërkoj nga panelit që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Ankesa aprovohet si e bazuar.

OSHP me datë 23.01.2017 autorizon ekspertin shqyrtues znj.Saramati dhe ekspertin teknik z.Sarkocevic përshqyrtimin e ankesës dhe trajtimin e pretendimeve ankimore, ku të njëjtit ekspert me datë 02.02.2017 i dorëzojnë panelit shqyrtues raportin e ekspertizës me analizë, konstatime dhe me rekomandim që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

OSHP me datë 02.02.2017 njoftohet nga OE se pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues.

Po ashtu me 02.02.2017 AK-EKK njofton panelin se nuk pajtohen me raportin ekspertit shqyrtues.

Në seance dëgjimore të mbajtur me dt.27.02.2017 ku të pranishëm ishin përfaqsuesi I OE ankues,eksperti shqyrtues dhe ai teknik,për séance ishin të ftuar edhe përfaqsuesit e AK-KEK të cilin nuk ishin present për arsye të panjohura për panelin shqyrtues,paneli shqyrtues shqyrtoi shkresat e lëndës dhe atë:dosjen e tenderit me specifikime teknike,ankesën e OE,raportin e ekspertizës së ekspertve

teknik dhe shqyrtues,përgjigjet nga na e AK dhe OE ankues lidhur me këtë raport të ekspertizës si dhe bëri dëgjimin e palëve kun ë fillim fjala ju dha përfaqsuesit të OE ankues I cili deklaroj:

Qëndrojmë pran pretendimeve ankimore dhe mbështesim raportin e ekspertëve shqyrtues dhe atij teknik.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues znj.Saramati e cila deklaroj:

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë qenë të gjitha për specifika teknike andaj fjalën do ja kaloja ekspertit shqyrtues teknik.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Sarkocevic deklaroj:

Kur janë në pyetje kushinetat, te ato ka rëndësi cilin lloj të ngarkesë bartin, është në pyetje ngarkesa radiale, aksiale apo radiale aksiale. Po ashtu dimensionet janë me rëndësi.

Dimensionet e diametrit të brendshëm, të jashtëm , dhe gjerësia e kushinetës.

Gjitha shenjat tjera shënojnë disa specifika tjera të kushinetave, psh a është e mbyllur në dyja anët, çfarë lloj të mbulesës e ka.

Sipas kësaj çfarë kam gjetur në krahasim me prodhues të ndryshëm, siç kam cek në raport edhe këto kushineta të ofruara i përshtaten kërkesave të KEK.

Kam qenë pak skeptik kur kam parë prodhues nga Kina, mirëpo ata kanë certifikatë të sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Të dy OE kanë ofruar prodhime nga prodhues nga Kina mirëpo kanë certifikatat e cilësisë.

Në pyetje të kryetarit të panelit se a ka plotësuar OE ankues kërkesat e dosjes për specifika teknike të AK-së , në përgjigje z.Sarkocevic deklaroj:

"PO, operatori ekonomik ankues "SNR" plotëson kërkesat e dosjes së tenderit".

Paneli shqyrtues gjatë séances dëgjimore konfirmoi se qëndron pretendimi ankimor I OE ankues se AK nuk ka vepruar drejtë me rastin e vlersimit të ofertës ku pa të drejtë është elimnuar nga ky aktivitet I prokurimit dhe se ka plotësuar kërkesat e AK si për artikujtë 6;8;17;18;21;23 të DT dhe specifikimeve teknike këtë e konfirmoi edhe eksperti teknik gjatë séances dëgjimore.

Paneli shqyrtues pati parasysh raportin e ekspertit teknik dhe deklarimin e tij gjatë séances dëgjimore se OE ankues I plotës kërkesat e DT dhe ofertya e OE ankues është konforë DT dhe specifekave teknike.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si: dosjen e tenderit me specifikime teknike,ankesën e OE,raportin e ekspertizës së ekspertve teknik dhe shqyrtues,përgjigjet nga na e AK dhe OE ankues lidhur me këtë raport të ekspertizës si dhe dëgjimin e palëveve ia fali besimin ekspertit teknik lidhur me këtë aktivitet të Prokurimit.

Andaj paneli shqyrtues nga provat e cekuar më lartë ,në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendim nuk është e lejuar ankesa. Palët e pakënaqura kundër këtij vendimi mund të ushtrojnë kërkesë-padi për kompenzim dëmi në Gjykatën Themelore

Departamenti Administrativ në afat prej 30 ditësh.

KRYETARI I PANELIT SHQYRTUES

Tefik Sylejmani

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROCEDURËS TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE PRISHTINË REPUBLIKA KOSOVA